

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANË  
NR. 27845 VENDIMI

27845

VENDIM  
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, më datë 3/06.2002

unë gjyqtarja e Gjykatës së shkalles pare Tiranë, ALTINA XHOXHAJ, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Nasser Mohamed Abdulmohsen Al- Kharafi, me cilësinë e presidentit të Keshillit të Drejtueseve të shoqërisë "Banka e Kreditit të Shqipërisë "Sh.A perfaqesuar me prokure të posacme nga Tarek Mohamed Soliman, si dhe dokumentat e tjera bashkangjitur,

KONSTATOVA

Se kerkuesi Nasser Mohamed Abdulmohsen Al- Kharafi me cilësinë e presidentit të Keshillit të Drejtuesve të shoqërisë "Banka e Kreditit të Shqipërisë" Sha, ka bërë kërkesë për regjistrimin si Person Juridik në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së shkalles pare Tiranë të Bankës së Kreditit të Shqipërisë, në formën e një shoqërie aksionere. Kjo Shoqëri do ta zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshmet e bëra nga Ligji Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Për Bankat ne Republikën e Shqipërisë". Kohëzgjatja e aktivitetit të Bankës është e pakufizuar.

Kapitali total i Bankës është shtate qind milion (700 000 000) lek, dhe numri i aksioneve të autorizuar në të cilën do të ndahet ky kapital është tridhjetë pese mijë (35 000) aksione me një vlerë nominale prej njezet mijë (20 000) lek për aksion. I gjithë kapitali aksioner i Shoqërisë i përket plotësisht Aksionereve Themelues ne menyre te barabarte që jane:

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi

Objekti i Bankës është kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Per Bankat ne Republikën e Shqipërisë" në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen. Specifikisht, Banka mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe çertifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontratat "e mudësive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumentave të normës së interesit; (d) kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit); (f) ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e shërbimeve si agjent financiar, ose këshilltar financiar si dhe të gjitha aktivitetet financiare që do të përcaktohen në licensën përfundimtare të Bankës së Shqipërisë. Meqenëse aktiviteti bankar

është një aktivitet i licensuar, Banka ka paraqitur edhe licensën e përkohshme për zhvillimin e aktivitetit të lëshuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me Ligjin Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Për Bankat ne Republikën e Shqipërisë".

Selia e Bankës është në Tiranë me adresë: Rr Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Administration Building, kati i I & 2.

Këshilli i Drejtuesve të Bankës përbëhet nga këta anëtarë:

1. Nasser Kharafi , president I Keshillit Drejtues
2. Mohamed Ali Faramay
3. Omar Dessouki
4. Ahmet Sharawi
5. Ahmed Sami

Drejtor ekzekutiv i Bankës në Shqipëri, do të jetë Shahin Serag El – Din.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", dhe Ligji, Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Për Bankat ne Republikën e Shqiperise"

### VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise " Banka e Kreditit te Shqiperise" Sh. A.

Aksioner themelues te Bankes jane :


Jassim Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi

Nasser Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi

Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi

Kapitali fillestar i paguar i Bankës është shtatë qind milion leke (700 000 000) lek, dhe është paguar prej Aksionereve Themelues në para. Numri i aksioneve të autorizuara në të cilën do të ndahet ky kapital është tridhjetë pese mijë (35 000) aksione me një vlerë nominale prej njezet mije (20 000) lek për aksion. Ky kapital I takon aksionereve themelues ne pjese te barabarta .

Objekti i i veprimtarise se shoqerise eshte kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Per Bankat ne Republikën e Shqipërisë" në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen. Specifikisht, Banka mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimin e depozitave (në fromën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe çertifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontratat "e mudësive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumentave të normës së interesit; (d) kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit); (f) ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e shërbimeve si agent financiar, ose këshilltar financiar si dhe të gjitha aktivitetet financiare që do të përcaktohen në licensën përfundimtare të Bankës së Shqipërisë.



2

Selia e Bankës është në Tiranë me adresë: Rr Perlat Rexhepi , Al-Kharafi Group  
Adminstration Building , kati i I & 2 .

Këshilli i Drejtuesve të Bankës përbëhet nga këta anëtarë:

Nasser Mohamed Abdulmohsen Al -Kharafi, president I Keshillit Drejtues.

Mohamed Ali Faramay

Omar Dessouki

Ahmet Sharawi

Ahmed Sami

Drejtor ekzekutiv i Bankës në Shqipëri, do të jetë Shahin Serag El – Din.

Shoqëria do të fillojë aktivitetin me marrjen e licensës përfundimtare nga Banka e Shqipërisë.


Kundër këtij vendimi lejohet ankim në shkallë të dytë.

Tirane me 3/6/2002

3/6/02

**GJYQTARE**


**ALTINA XHOXHAI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

NR. 27845/1



**VENDIM**

**I GJYOTARES SE VETME**

Sot, me date 29.02.2003, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit z. Tarek Mohamed Soliman perfaqesuar me prokure te posacme te shoqerise anonime "BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE" SHA, i cili kerkon depozitim e Mbledhjes se Zakonshme te Bordit te Drejtoreve date 01 shkurt 2003 dhe ;

**K O N S T A T O V A ;**

Me vendimin nr.27845, date 03.06.2002 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria anonime "Banka e kreditit te Shqiperise" SHA eshte me aksionere Jassim Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi, Nasser Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi dhe Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al Kharafi, me kapital fillestar shtatqind milion leke (700.000.000) leke, objekti i shjoqerise eshte kryerja e aktivitetit te sherbimeve bankare dhe financiare ne perputhje me ligjin nr.8365, date 02.07.1998 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise". Selia e Bankes eshte ne Tirane, me adrese rruga "Perlat Rexhepi". Keshilli i drejtuesve te Bankes perbehet nga keta anetare : Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi, president i keshillit Drejtues, Mohamed Ali Faramay, Omar Dessouki, Ahmer Sharawi dhe Ahmed Sami, me drejtor ekzekutiv i Bankes ne Shqiperi do te jete z. Shahin Serag El-Din.

Me vendimin e Bordit te drejtoreve te Bankes se Kreditit te Shqiperise te mbajtur me date 01 shkurt 2003 eshte vendosur te pranohet doreheqja e zoterise Shahin Serag El Din dhe te emerohet zoteria Kamal Abdel Moneim si zevendes drejtor i Bankes.

Kerkesa e tij per t'u bere ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrimit tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE ;**

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrimin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

**V E N D O S A ;**

Pranimin e kerkeses.

Depozitim e Mbledhjes se zakonshme te Bordit te Drejtoreve te Bankes se kreditit te Shqiperise te mbajtur me date 01 shkurt 2003 ku eshte vendosur qe te pranohet doreheqja e zoterise Shahin Serag El Din dhe te emerohet zoteria Kamal Abdel Moneim si zevendesdrejtor i Bankes.

Duke urdheruar kete zyre per te bere ndryshimet e nevojshme ne Skeden perkatese te kesaj shoqerie ne kollonen 4, 5 me numer rendor 3, duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE  
*Shahin Serag El-Din*  
*Abdel Moneim*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR.27845/2

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 2. 4. 2004, une Mr. Doggo, gjyqtare prane gjykates se shkalles se pare Tirane, pasi studiova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Kamal Abdel Moneim i cili eshte mandatuar nga Asambleja e Aksionereve per depozitimimin e dy vendimeve te Mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" sha;

KOSTATOVA SE:

Shoqeria "Banka e Kreditit te Shqiperise" eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.27845 date 03.06 2002 te gjykates se shkalles se pare Tirane, me aksionere:

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi

Shoqeria e ka seline ne rrugen: "Perlat Rexhepi,, Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1 &2, me kapital aksioner 700.000.000 (shtate qind milion) leke.

Me date 29.08.2003 me kerkese te Bordit te Drejtoreve eshte zhvilluar mbledhja e jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" sha e perbere nga aksioneret:

Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi, Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi, Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi e cila ne unanimitet vendosi:

- 1 Te ndryshoje nenin 6 te statutit te shoqerise, duke ndryshuar kapitalin e bankes nga leke ne dollare amerikane dhe konkretisht; 700.000.000 (shtate qind milion) leke qe eshte kapitali fillestar i shoqerise duke u konvertuar ne dollare sipas kursit te kembimit valutor te dates 16.05.2002 jane te barasvlefshme me 5.000.000 USD (pese milion dollare amerikane.)
- 2 Te rrise kapitalin total te bankes nga 5.000.000 USD (pese milion dollare amerikane) ne 6.000.000 USD (gjashte milion dollare amerikane) te ndara ne 6.000 aksione me vlere nominale prej 1.000 USD secila. Kapitali i aksioneve te bankes eshte i teri i atribuar aksionereve themelues.
- 3 Caktohet Z. kamal Abdel Moneim per te depozituar kete vendim ne gjykatën e shkalles se pare Tirane per te bere ndryshimet perkatese ne zyren e rregjistrimit tregtar.

Me date 11. 02.2004 me kerkese te Bordit te Drejtoreve u mbajt Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" ne te cilin moren pjese te tre aksioneret te cilet vendosen unanimitisht:

- 1 Te rrisin kapitalin e bankes me 1.800.000 USD (nje milion e teteqind mije dollare amerikane. Shuma totale e kapitalit te bankes eshte 7.800.000 USD ( shtate milion e teteqind mije dollare amerikane) dhe numri i aksioneve te autorizuar eshte 7.800

(shtate mije e teteqind) duke pasur nje vlere nominale prej 1.000 USD ( njemije dollare amerikane ) per aksion. Kapitali i aksioneve te bankes eshte i teri i atribuar aksionereve themelues.

- 2 Te caktoje z. Kamal Abdel Moncim te depozitoje kete vendim ne gjykatën e shkalles se pare Tirane duke u bere ndryshimet respektive ne regjistrin tregtar.


#### **PER KETO ARSYE:**

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne ligjin nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

#### **VENDOSA:**

- Pranimin e kerkeses;
- Depozitimn e vendimit date 28.09.2003 dhe te vendimit date 11.02.2004 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit e Shqiperise".
- Urdherohet zyra e Rregjistrin Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise.

GJYQTARE

  
Mylinda Dajpe

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
NR. 27845 / VENDIMI

3.

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Në Tiranë, sot në datën 18.10. 2005, unë gjyqtarja Ariana Caco, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi u njoha me kërkesën e kërkuarit

**KONSTATOVA SE**

“BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE” (CBA) sha eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.27845 date 03.06.2002, te Gjykares se Shkalles se Pare Tirane.

Me vendimin e dates 23.06.2005 Aksioneret qe zoterojne 100% te aksioneve te Bankes se Kredit te Shqiperise (CBA) sha, zoterinjte: 1. Jassim M.A. Al-Kharafi; 2.Nasser M.A. Al-Kharafi; 3. Fawzi M.A. Al-Kharafi; kane vendosur

- Miratimin e bilancit te dates 31 Dhjetor 2004
- Miratimin e Auditimit te Jashtem per vitin e kaluar i cili perfundoj ne 2005. Aksioneret rane dakort te caktojne kompanine “KPMG Albania” shpk si Auditor te Jashtem te bankes, e cila do te jete pergjegjese per auditimin e llogarive dhe do te pergatise bilancin dhe raportin financiar kundrejt nje shume prej 10.500 Euro perjashtuar TVSH-ne.
- Ndryshimin e nenit 9 “Komitetet” ne Statutin e Bankes se Kredit te Shqiperise  
Abrogohet “Komiteti i Konfliktit te Interesave” dhe pergjegjesite dhe detyrimet e ketij komiteti ti trasferohen “Komitetit te Auditimit”.
- Emerimin e antareve te rinj te Komitetit te Auditimit  
Asambleja e Aksionereve ka rrene dakort te emeroje te poshte permendurit ne Komitetin e Auditimit
  1. Z. Drini Salko kryetar
  2. Z. Benet Beci antar
  3. Znj. Elvana Sharkaj antare
- Ngarkohet Z. Kamal Abdel Moneim te depozitoje kete vendim ne Gjykatën e Tiranës.

Me anë të kërkesës së tij kërkuari kërkon depozitim të këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar duke u bërë shënime përkatëse.

Kërkesa e tij është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Ligjin Nr. 7667 datë 28. 01. 1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare"

### VENDOSA

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitimin pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të Vendimit të Aksionereve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë (CBA) datë 23. 06. 2005
- Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të bëjë ndryshimet e duhura;

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi.

**GJYQTARE**

Armenia Caco





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Nr. 27895/4 Vendimit

V E N D I M  
I  
GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 28/9/2006, unë Majlinda DOGGA gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., përfaqësuar nga Drejtori Z. Kamal Abdel Moneim, i cili është ngarkuar nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve për depozitimin e Vendimi të saj datë 08.05.2006

**KONSTATOVA SE :**

Shoqëria Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 27845, datë 03.06.2002 dhe ushtron aktivitet në përputhje me aktet e themelimit dhe legjislacionin në fuqi.

Me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, të datës 08.05.2006, zmadhimi i kapitalit të bankës nëpërmjet emetimit të 1500 aksioneve shtesë të kapitalit me vlerë nominale 1000 USD secila. Emetimi i aksioneve bëhet nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve ku secili prej tyre përfiton nga 500 aksione. Shlyerja e aksioneve, sipas kontributit në të holla është bërë nga ortakët pranë Bankës së Kreditit të Shqipërisë dhe nga kjo e fundit ka kaluar në llogarinë e kapitalit të Shoqërisë, sipas dokumentave të bashkëngjitura vendimit.

Si pasojë e këtij zmadhimi, kapitali i nënshkruar i shoqërisë do të jetë në vlerën 9.300.000 (nëntëmilion e treqind mijë dollarë amerikan) USD i ndarë në 9.300 (nëntëmijë e treqind) aksione, me vlerë nominale të një aksioni prej 1000 (njëmijë) USD. Aksionerët pas zmadhimit ruajnë të njëjtat përqindje në zotërimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve, datë 08.05.2006, është e plotë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar”,

## V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., datë 08.05.2006 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë ndryshimet në kollonën përkatëse.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligj.

G J Y Q T A R E  
Majlinda DOGGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Nr. 27845/5 Vendimit

V E N D I M  
I  
GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 17/04/2007, unë Blerina MUÇA gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., përfaqësuar nga Drejtori Z. Kamal Abdel Moncim, i cili është ngarkuar nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve për depozitimin e Vendimi të saj datë 05.02.2007,

**KONSTATOVA SE :**

Shoqëria Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 27845, datë 03.06.2002 dhe ushtron aktivitet në përputhje me aktet e themelimit dhe legjislacionin në fuqi.

Me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, të datës 05.02.2007, zmadhimi i kapitalit të bankës nëpërmjet emetimit të 1800 aksioneve shtesë të kapitalit me vlerë nominale 1000 USD secila.. Emetimi i aksioneve bëhet nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve ku secili prej tyre përfiton nga 600 aksione. Shlyerja e aksioneve, sipas kontributit në të holla është bërë nga ortakët pranë Bankës së Kreditit të Shqipërisë dhe nga kjo e fundit ka kaluar në llogarinë e kapitalit të Shoqërisë, sipas dokumentave të bashkëngjitura vendimit.

Si pasojë e këtij zmadhimi, kapitali i nënshkruar i shoqërisë do të jetë në vlerën 11.100.000 (njëmbëdhjetë milion e njëqind mijë dollarë amerikan) USD i ndarë në 11.100 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind) aksione, me vlerë nominale të një aksioni prej 1000 (njëmijë) USD. Aksionerët pas zmadhimit ruajnë të njëjtat përqindje në zotërimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve, datë 05.02.2007, është e plotë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërisë Tregtare”,


## V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit të Shqipërisë” Sh.a., datë 05.02.2007 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet në kollonën përkatëse.

Nëndër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligj.


G J Y Q T A R E

Blorina MUCA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT  
TIRANE



Nr.2331 Regj.Themeltar  
Nr.1122 Vendimit

V E N D I M

“ NE EMER TE REPUBLIKES ”

Gjykata e Apelit Tirane e perbere prej:



KRYESUES : LEFTER JAHAJ  
ANETAR : PAJTIM HOXHA  
ANETAR : ZAMIR PODA

Sot ne dt.02.10.2007 ne seance gjyqesore me dyer te hapura, mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe i perket paleve :

**PADITES**

- : 1-Gjergji Kratellari, i biri i Jovanit, i dtl.1962, banues ne Tirane, perfaqshuar nga av.Delo Isufi.
- 2-Petro Bubuci, i biri i Kocos, i dtl.1956, lindur e banues ne Sarande, ne mungese.
- 3-Koco Bubuci, i biri i Petros, dtl.1929, banues ne Sarande, ne mungese.

**TE PADITUR**

- : 1-Fitnete Meta, e bija e Hasanit, dtl.1957, lindur ne Burrel e banuese ne Tirane.
- 2-Natasha Koci, e bija e Velos, dtl.1951, lindur ne Vlore e banuese ne Tirane, te perfasuar nga av.Monika Gugu.

R A N E

SHQERISE  
AZI

**3-Gani Hoxha**, i biri i Selmanit, dtl.1963  
lindur ne Burrel e banues ne Tirane.

**4-Hysen Shahu**, i biri i Haderit, dtl.1942,  
banues ne Tirane.

**5-Vangjel Birbo**, i biri Josifit, dtl.1958,  
banues ne Tirane, te perfaqsuar nga  
av.Dashamir Kore.

**6-Shoqeria Anonime "Intersig" Sh.a.**

**ME OBJEKT**

- : -Zgjidhjen e kontratave te shitjes se Aksioneve per shkak te mospermbushjes se detyrimit kontraktor te kontratave Nr.1860/630 dt.20.04.2006, kontrata Nr.1859/629/1 dt.20.04.2006 e kontrates Nr.1856/626/1 dt.20.04.2006.
- Prishjen me nenvizim te vendimit ne rregjistrin tregtar.
- Ç' rregjistrimin nga libri i Aksioneve te Shpqerise, i aksioneve te paleve te paditura ne baze te kontratave te shitjes.
- Marrjen e mases se sigurimit te padise.
- Pezullimin e depozitimit te akteve ne regjistrin tregtar te Shoqerise "Intersig"  
*Neni 690, 693, 698, 703/1, 705, 730, 733, 737/1 te K.Civil.*

**Gjykata e Rrethit Tirane**, me vendimin e saj Nr.1219 dt.23.02.2007  
ka vendosur :

- Pranimin e kerkese padise
- Zgjidhjen e kontrates se shitjes se aksioneve Nr.1856 Rep, 626/1 Kol, dt.20.04.2006 lidhur midis paditesit Koco Bubuci dhe pales se paditur Hysen Shahu, Fitnete Meta, Gani Hoxha, Natasha Koci e Vangjel Birbo.



- Zgjidhjen e kontrates se shitjes se aksioneve Nr.1859/629/1 Kol dt.20.04.2006 lidhur midis paditesit Petro Bubuci e pales se paditur Hysen Shahu, Fitnete Meta, Gani Hoxha, Natasha Koci e Vangjel Birbo.

- Zgjidhjen e kontrates se shitjes se aksioneve Nr.1860 Rep, 630 Kol, dt.20.04.2006 lidhur midis paditesit Gjergji Kratellari e pales se paditur Hysen Shahu, Fitnete Meta, Gani Hoxha, Natasha Koci e Vangjel Birbo per mospermbushje te detyrimit kontraktor, mospagim te cmimit.

- Pushimin e gjykimit per pjesen tjeter te kerkese padise.

• **Kunder ketij vendimi kane bere ankim te paditurit duke parashtruar keto shkaqe per ndryshimin e vendimit :**

- *Vendimi i gjykates eshte i pabazuar ne prova e ligj.*
- *Gjykata nuk ka vleresuar drejt provat e paraqitura nga ana jone.*
- *Ka mbivleresuar provat e paditesit duke na diskriminuar ne.*
- *Ka vepruar ne kundersizim me nenin 253 te K.Pr.Civile.*
- *Te paditurit e kane permbushur detyrimin ndaj paditesit Gjergji.*
- *Per kete ai ka leshuar dokumenta noteriale.*
- *Ky akt nuk eshte goditur per fallsifikim.*

*Kerkojme prishjen e vendimit e rrezimin e kerkese padise.*

## **GJYKATA E APELIT TIRANE**

Pasi shqyrtoi aktet e bisedoi çeshtjen ne teresi, degjoi av.Dashamir Kore qe kerkoi prishjen e vendimit e rrezimin e kerkese padise, degjoi av.Delo Isufi qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, av.Monika Gugu qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit :

### **VEREN**

Nga materialet e çeshtjes ka rezultuar se paditesat Gjergji Kratellari, Petro Bubuci e Koco Bubuci me kerkese padine drejtuar Gjykates se Shkalles Pare Tirane kane kerkuar zgjidhjen e kontratave te shitjes se aksioneve per shkak te mospermbushjes se detyrimeve kontraktore.

Hetimi gjyqesor ka provuar se sipas vendimit Nr.26103 dt.18.07.2001 paditesat Gjergji Kratellari, Petro Bubuci e Koco Bubuci jane tre aksioneret themelore te shoqerise "Intersig" me objekt te



veprimtarise, dhe kapital themeltar, sipas statutit te nenshkruar dhe depozituar ne rregjistrin tregetar.

Paditesi Gjergji Kratellari ka patur ne kete shoqeri 720 aksione, Petro Bubuci 720 aksione dhe Koco Bubuci 640 aksione.

Me vullnetin e tyre te lire ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992, eshte kryer transferimi nepermjet shitjes se aksioneve nga paditesat te pala e paditur nepermjet kontratave te shitjes Nr.1860/630 dt.20.04.2006 me pale shitese Gjergji Kratellari dhe paleve blerese Gani Hoxha, Hysen Shahu, Fitnete Meta, Natasha Koci e Vangjel Birbo me objekt, tregtimi i 720 aksioneve zoteruese te paditesit Gjergji Kratellari te pala blerese Gani Hoxha 102 aksione, Fitnete Meta 102 aksione, Hysen Shahu 102 aksione, Narasha Koci 214 aksione, Vangjel Birbo 200 aksione me vlere totale 4.500.000 leke.

Kontrata e shitjes se aksioneve Nr.1856/626/1 dt.20.04.2006 me pale shitese Koco Bubuci me pale blerese Gani Hoxha, Hysen Shahu, Fitnete Meta, Natasha Koci e Vangjel Birbo me objekt, tregtimi i 640 aksioneve zoteruese te shitesit Koco Bubuci te bleresat perkatesisht Gani Hoxha 90 aksione, Fitnete Meta 90 aksione, Hysen Shahu 90 aksione, Natasha Koci 174 aksione e Vangjel Birbo 196 aksione me vlere totale te aksioneve 4.000.000 leke.

Kontrata e shitjes se aksioneve Nr.1859/629/1 dt.20.04.2006 me pale shitese Petro Bubuci e pale blerese Gani Hoxha Gani, Hysen Shahu, Fitnete Meta, Natasha Koci e Vangjel Birbo me objekt, tregtimin e 720 aksioneve me vlere totale 4.500.000 leke bleresit Gani Hoxha 102 aksione, Fitnete Meta 102 aksione, Hysen Shahu 102 aksione, Natasha Koci 214 aksione e Vangjel Birbo 200 aksione.

Duke u bazuar ne nenin 3 te kontratave ne te cilin thuhet, se shuma qe perben cmimin e shitjes do te paguhet menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate. Paditesat duke pretenduar se te paditurit nuk e kane permbushur kete detyrim i jane drejtuar me padi Gjykates se Faktit Tirane duke kerkuar zgjidhjen e kontrates shitjes se aksioneve.

Gjykata e faktit, pasi ka gjykuar ceshtjen e degjuar palet, ka administruar provat shkresore, ne perfundim te gjykimit ka vendosur : pranimin e kerkese padise.

Gjykata ne vendimin e saj i referohet vetem nenit 3 te kontrates, duke arsyetuar, se te paditurit nuk kane shlyer asnje lek sipas kontrates. Po keshtu, Gjykata e Faktit nuk ka marre per baze as dokumentat noteriale



te leshuara nga paditesi Gjergji Kratellari ne te cilen thuhet, se eshte shlyer me te gjithë shumen e ai nuk ka ndonje pretendim ndaj bleresve te aksioneve.

Gjykata e Apelit pasi e shqyrtoi ceshtjen ne teresi, degjoi palet konstaton, se vendimi i Gjykates Faktit duhet te ndryshohet duke ju rrezuar kerkese padia paditesave.

Keshtu, Gjykata e Apelit konstaton, se paditesi Gjergji Kratellari ka qene zoterues i 720 aksioneve ne kete shoqeri. Me vullnetin e tij te lire keto aksione ju a ka shitur te paditurve. Ne baze te pikes 3 paragrafi i fundit i kesaj kontrate thuhet se : ***“Transferimi ligjor i aksioneve ne rregjistrin perkates dhe ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane do te kryhet vetem pasi te jete kryer pagesa dhe kjo te jete pranuar me deklarate noteriale nga bleresit, qe kane likujduar plotesisht detyrimin e kontrates dhe nga shitesi qe ka marre ne zoterim shumat e mesiperme“.***

Ne seance gjyqesore te paditurit Hysen Shahu etj, kane deklaruar se i kane likujduar paditesat paditesin Gjergji Kratellari, dhe ky i fundit ne deklaraten noteriale Nr.3219/1812 dt.21.04.2006 pra, nje dite pas kontrates se shitblerjes se 720 aksioneve me vullnetin e tij te lire ka deklaruar se eshte likujduar plotesisht me shumen perkatese. Paditesi Gjergji ka deklaruar se firma ne kete deklarate noteriale eshte e tija.

Sipas nenit 253 te K.Pr.Civile kjo deklarate noteriale eshte nje akt zyrtar i perpiluar nga noteri, i cili eshte person qe ushtron veprimtari publike brenda kopetences dhe ne formen e caktuar. Sa siper, ky akt perben prove te plote per te gjitha deklarimet qe jane bere para noterit. Po ne baze te nenit 253 te K.Pr.Civile, ***“Lejohet te provohet e kunderta e permbajtjes vetem kur pretendohet se shkresa eshte e fallsifikuar“.***

Hetimi gjyqesor, e provat e administruara ka provuar se asnje nga pjesmarresit ne proces nuk ka pretenduar se kjo deklarate noteriale eshte e fallsifikuar.

Gjykata e Faktit, ne kundershtrim me sa siper ka pranuar te kunderten e permbajtjes qe parashikon kjo prove.

Gjithashtu, gjykata me vleresimin e vleren provuese te kesaj prove ka vepruar ne kundershtrim me percaktimet e nenit 257 te K.Pr.Civile ne te cilin thuhet : ***“Shkresa qe perpilohet ne baze te nenit 253 per kryerjen ose vertetimin e veprimit juridik, persa i perket deklarimit te paleve, perben prove te plote per te gjithë“.***

Persa i perket paditesave Petro e Koco Bubuci, Gjykata e faktit arsyetimin e saj e mbeshtet vetem ne paragrafin e pare te nenit 3 te kontrates ne te cilin thuhet, se pagesa e cmimit do te behet menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate. Gjykata e Apelit cmon, se Gjykata e faktit ka bere nje interpretim te njeanshem te kontrates ne favor te paditesave.

Ne rastin konkret, nuk kemi mospermbushje te detyrimit ne kuptimin ligjor, kemi mospermbushje te detyrimit vetem ne ato raste kur detyrimi qe eshte percaktuar ne kontrate nuk eshte permbushur mbasi eshte plotesuar afati pagimit. Kjo eshte e vlefshme per veprimet juridike me afat.

Ne rastin konkret nuk eshte vendosur ndonje afat i percaktuar ne kontrate.

Ky arsyetim del nga interpretimi ne teresi i nenit 3 te kontrates ne te gjitha pikat e saj.

Ne qoftese do pranohet "*termi menjehere*" i pagimit me nenshkrimin e kontratave do te thote, se afati pagimit do te ishte data e nenshkrimin te kontratave pra, 20.04.2006.

Ne paragrafin e fundit te nenit 3 te kontrates behet fjale se koha e pagimit nuk eshte data e nenshkrimin te kontrates, pasi vete kontrata eshte akt noterial, dhe duke qene keshtu nuk ka kuptim qe pagesa e cmimit te fiksohet me nje akt tjeter noterial sic thuhet ne paragrafin e fundit te ketij neni. Pra, kemi te bejme me dy akte noteriale qe nuk perkojne ne kohe me njeri tjetrin.

Sipas nenit 463 e 464 te K.Civil, afati i ekzekutimeve te detyrimeve per veprimet juridike per te cilat nuk eshte caktuar afat konkret fillon mbasi kreditori ka bere kerkesen per plotesimin e menjehershem te detyrimit. Hetimi gjyqesor ka provuar, se paditesat Koco e Petro nuk i kane njoftuar asnjehere te paditurit me shkrim per permbushjen e detyrimit as kane caktuar afat, as kane caktuar se si do te behet shlyerja e ketij detyrimi.

Provat e administruara ne seance gjyqesore tregojne se te paditurit Gani, Hysen e Vangjel kane bere perpjekje per te shlyer detyrimin paditesave Petro e Koco.

Ne keto rrethana e ndodhur ceshtja, nga analiza e provave e llogjika e fakteve te marra ato ne unitet Gjykata e Apelit cmon, se vendimi Gjykates faktit duhet te ndryshohet dhe te rrezohet kerkese padia si e pabazuar.

**PER KETO ARSYE**

Trupi gjykues ne baze te nenit 466/b te K.Pr.Civile :

**VENDOSI**

Ndryshimin e vendimit te Gjykates se Shkalles Pare Tirane Nr.1219 dt.23.02.2007 dhe rrezimin e kerkese padise te paditesave Gjergji Kratellari, Petro Bubuci e Koco Bubuci.

*Tirane, me 02.10.2007*

**ANETAR  
Z. PODA  
d.v.**

**ANETAR  
P. HOXHA  
d.v.**

**KRYESUES  
L. JAHAJ  
d.v.**

**Vertetohet njesia me origjinalin**

**KANCELARE  
Elka DAJÇI**

**PULLE TAKSE**

**100  
LEKE  
RISHQIPERISE**


Dak.Y.C.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
TIRANE  
Nr. 576 Rep.

VERTETIM

Sot, me date 20 nentor 2007 (dymije e shtate), para meje noteres se Zyres se Noterise Tirane Blerina AVRAZI, me adrese Rr."Duresit", pall.204, u paraqit z.Vangjel BIRBO, i biri i Josifit, i dtl.20.02.1958, lindur dhe banues ne Tirane, ne adresen : Rr."Xhoxhi Martini", Pallati Colombo, ap.6/5, shtetas shqiptar, madhor me zotesi të plote per të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr.Z0786611, i cili paraqiti dokumenti origjinal : Vendim i Gjykates se Apelit Tirane Nr.1122 date 02.10.2007. Pasi e verifikova, konstatova se nuk ka fshirje apo korrigjime, une Noterja e fotokopjova dhe e vertetoj nje me origjinalin rregullisht, ne baze te nenit 56 te Ligjit "PER NOTERINE".

NOTERE  
Blerina AVRAZI





**AKTI I THEMELIMIT  
TE  
"BANKES SE KREDITIT TE SHQIPERISE "  
Shoqeri Anonime**

Ne te nenshkruarit:

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi

Me cesesine e aksionereve themelues themeloj shoqërinë anomime "BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE" SHA me ane të nënshkrimit të këtij Akt Themelimi.

**NENI 1**

Shoqëria " Banka Kreditit te Shqiperise" SHA, (më poshtë refereuar edhe si 'Banka') është shoqëri anonime selia e së cilës është në Tiranë, rr Perlat Rexhepi, godina e administratese se grupit Al-Kharafi , kati I 1<sup>re</sup> & 2<sup>te</sup>., Shqipëri.

Afati i veprimtarisë së Bankës është i pakufizuar

**NENI 2**

Objekti i Bankës është kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8365 , datë 2.7.1998 " Per Bankat ne Republiken e Shqiperise", në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen. Specifikisht, Shoqëria mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe çertifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontartat "e mudësive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumentave të normës së interesit; (d) kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit); (f) ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e shërbimeve si agjent financiar, ose këshilltar financiar të gjitha aktivitetet financiare që do të përcaktohen në licensëpërfundimatare të e Bankës së Shqipërisë.

**NENI 3**

Themelues te Shoqërisë jane aksioneret :

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,

2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi

Te cilet kane kontribuar ne menyre te barabarte ne kapitalin themeltar te shoqerise .

#### NENI 4

Kapitali total i Bankës është shtate qind milion (700,000,000) leke, dhe numri i aksionerëve të autorizuar në të cilën do të ndahet ky kapital është 35 000 (tridhjetë pese mijë) aksione më një vlerë nominale prej njëqind (20 000) lek për aksion. I gjithë kapitali aksioner i Shoqërisë i përket plotësisht aksionerve themelues qe jane:

Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,  
Nasserf Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,  
Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi.

Kapitali fillestar i paguar i Bankës është 5 (pese) milion dollare amerikan , dhe eshte paguar nga Aksioneret Themelues në cash.

#### NENI 5

Këshilli i Drejtues i Bankës përbëhet nga këta anëtarë:

1. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al -Kharafi, president I keshillit drejtues
2. Mohamed Ali Faramawy
3. Omar Dessouki
4. Ahmed Sharawi
5. Ahmed Sami

Drejtor ekzekutiv I Bankes eshte zgjedhur Shahin Serag El-Din.

#### NENI 6

Veprimtaria e brendëshme e Bankës rregullohet nga Statuti i cili i bashkangjitet këtij Akti Themelimi.

Viti i Parë Fiananciar i Bankës fillon në datën e lëshimit të licensës përfundimtare nga Banka e Shqipërisë dhe mbaron më 31 Dhjetor.


Ky Akt Themelimi është përgatitur në gjuhën shqipe dhe angleze, në tre kopje dhe është nënshkruar prej themeluesve te shoqerise:

#### **AKSIONERET THEMELUES TE BANKES**

Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,

Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi,

Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 2029 REP  
NR 231 KOL



VERTETIM

Sot ne date 03-06-2002 para meje noteres ne dhomen e Noterise Tirane , u paraqit personalish perfaqesues me prokuren nr 3943 vell 4, date 5.3.2002 I aksionereve themelues te Bankes se Kreditit te Shqiperise:


1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi

Tarek Mohamed Soliman I cili deklaroi se akti I mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre dhe shpreh vullnetin e lire e te plote te perfaqesuarve prej tij, dhe atij vete, e nenshkruan kete akt para meje dhe une noterja e vertetoi sipas ligjit.



NOTERE

STATUT I  
SHOQËRISË ANONIME  
"BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE"  
SH.A.



---

NENI 1 - EMËRTIMI DHE STATUSI LIGJOR

Shoqëria "Banka e Kreditit te Shqiperise" (më poshtë referuar si "Banka"), është një shoqëri anonime e krijuar në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 12.1992. "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshmet e bëra nga Ligji Nr. 8365 datë 2.7.1998, "Për Bankat ne Republikën e Shqiperise". Aksioner themelues te Bankës jane :

1. JASSIM MOHAMED ABDULMOHSEN AL - KHARAFI
2. NASSER MOHAMED ABDULMOHSEN AL - KHARAFI
3. FAUZI MOHAMED ABDULMOHSEN AL-KHARAFI

NENI 2 - SELIA

Selia e Bankës është në Tiranë, Shqipëri. Adresa zyrtare e Bankës është: rr Perlat Rexhepi godina e administratese se grupit Al-Kharafi , kati I 1<sup>re</sup> & 2<sup>te</sup>.

NENI 3 - KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e afatit të veprimtarisë është e pakufizuar.

NENI 4 - OBJEKTI

Objekti i Bankës është kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Mbi Bankat ne Republikën e Shqipërisë" në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen. Specifikisht, Banka mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimi e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c)



marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe certifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontartat “e mudësive”, që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumentave të normës së interesit; (d) kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit); (f) ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e shërbimeve si agjent financiar , ose këshilltar financiar si dhe të gjitha aktivitetet financiare që do të përcaktohen në licensën e Bankës së Shqipërisë

## NENI 5 - DEGËT

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Banka mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë territorit të vendit.

## NENI 6 - KAPITALI

### Kapitali i Plotë Aksioner

6.1 Kapitali total i Bankës është 700 000 000 (shtateqind milion )lekë, dhe numri i aksioneve të autorizuar në të cilën do të ndahet ky kapital është 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) më një vlerë nominale prej njëqind 20 000( njezete mijë ) lek për aksion. I gjithë kapitali aksioner i Bankës i përket plotësisht Aksionereve Themelues dhe është i shlyer teresisht.

### Kapitali Fillestar i Paguar

6.2 Kapitali fillestar i paguar i Bankës është 700 000 000 leke dhe është paguar prej Aksionereve Themelues në para

### Rritja e Kapitalit

6.3 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, në një Mbledhje të Jashtëzakonshme është kompetente të rrisë më tej kapitalin aksioner të Bankës kur ta quajë të nevojshme për të bërë të mundur arritjen e objektivave Bankës



## NENI 7 - MBLEDHJET E AKSIONERËVE

### Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve

7.1 Organi kryesor vendimarrës i Bankës është Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (më poshtë referuar si "Asambleja e Përgjithshme"), e cila përbëhet prej gjithë aksionerëve të Bankës.

### Kompetencat

7.2 Kompetencat e Asamblesë përfshijnë të gjitha kompetencat që i jep asaj Ligji Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", Ligji Nr. 8365, datë 2.7.1998, "Per Bankat ne Republikën e Shqipërisë", dhe këtij Statuti.

### Mbledhjet e Zakonshme

7.3 Asambleja e Përgjithshme do të mbajë një Mbledhje të Zakonshme vjetore të aksionerëve të Bankës në selinë e Bankës në Tiranë, Shqipëri, ose në një vend tjetër me vendim unanim të aksionerëve, brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik, në datën, orën dhe vendin që vendos Këshilli i Drejtuesve, për të bërë zgjedhjen e Drejtorëve dhe kryerjen e të gjitha bizneseve të tjera që do t'i shtohen në mënyrën e duhur. Lajmërimi i mbledhjes që përmban qëllimin ose qëllimet e saj, kohën dhe vendin ku do të mbahet, do të bëhet duke botuar lajmërimin në një gazetë të autorizuar për të botuar lajme ligjore ose në mënyrë alternative, me anë të një letre rekomande të dërguar tek secili aksioner i regjistruar që ka të drejtë votë në këtë mbledhje. Lajmërimi duhet të botohet, ose letrat rekomande duhet të merren 15 ditë përpara mbledhjes.

7.4 Përveç Mbledhjes së Zakonshme vjetore të aksionerëve, Këshilli i Drejtuesve mund të thërrasë një Mbledhje të Zakonshme të aksionerëve kurdo që ta quajë të arsyeshme. Këshilli i Drejtuesve mund të thërrasë Mbledhjen e Zakonshme, mbi bazën e kërkesës me shkrim të Ekspertit të Autorizuar Kontabël të Bankës, të likujduesit të caktuar të bëjë likuidimin e Bankës, një ose më shumë aksionerëve që kontrollojnë, së bashku ose veçmas, të paktën një të dhjetën e Kapitalit të Bankës. Lajmi për thirrjen e Mbledhjes së Zakonshme, në të cilin do të përmbahen ora, vendi, qëllimi ose qëllimet e mbledhjes, do t'i jepet aksionerëve në mënyrën e parashikuar në Nenin 7.3 i cili parashikon mënyrën



e kryerjes së lajmërimit për Mbledhjet e Zakonshme vjetore.

#### Mbledhja e Jashtëzakonshme

- 7.5 Mbledhja e Jashtëzakonshme e aksionerëve mund të thirret në çdo kohë nga Këshilli i Drejtuesve. Mbledhja e Jashtëzakonshme mund të thirret prej Këshillit të Drejtuesve mbi kërkesën me shkrim të Ekspertit të Autorizuar Kontabël të Bankës, të likuidiesit të caktuar të bëjë likuidimin e Bankës, një ose më shumë aksionerëve që kontrollojnë, së bashku ose veçmas, të paktën një të dhjetën e Kapitalit të Bankës. Lajmi për thirrjen e Mbledhjes së Zakonshme, në të cilin do të përmbahen ora, vendi, qëllimi ose qëllimet e mbledhjes, do t'i jepet aksionerëve në mënyrën e parashikuar në Nenin 7.3 i cili parashikon mënyrën e kryerjes së lajmërimit për Mbledhjet e Zakonshme vjetore.

#### Quorumi dhe Marrja e Vendimeve në Mbledhje

- 7.6 Në rastin e Mbledhjes së Zakonshme të aksionerëve, quorumi ekziston kur në mbledhje janë të pranishëm aksionerët që zotërojnë të paktën gjysmën e të drejtave të votave. Në rast se nuk arritet quorumi, mbledhja mund të shtyhet për një moment të dytë jo më vonë se 2 muaj nga data e mbledhjes së parë. Në mbledhjen e dytë nuk ka kërkesa quorumi. Në një Mbledhje të Zakonshme të mbajtur në mënyrën e duhur, vendimet merren me shumicën e votave të aksioneve të përfaqësuara në mbledhje.
- 7.7 Në rastin e një Mbledhjeje të Jashtëzakonshme, quorumi ekziston kur janë të pranishëm aksionerë që zotërojnë të paktën gjysmën (1/2) e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet quorumi, takimi shtyhet për një datë tjetër jo më vonë se dy muaj nga data e takimit të parë. Në Mbledhjen e Dytë duhet të jenë të pranishëm të paktën një e katërta (1/4) e aksionerëve. Vendimet në Mbledhjet e Jashtëzakonshme merren me votimin pro të tre të katërtave 3/4 të aksioneve të përfaqësuara në mbledhje.

NENI - DREJTIMI I BANKËS

#### Këshilli i Drejtuesve



8.1 Punët dhe biznesi i Bankës drejtohen nga Këshilli i Drejtuesve i përbërë nga pesë Drejtorë, secili i zgjedhur për një periudhë katër vjeçare. Këshilli I pare drejtues perbehet nga :

1. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al -Kharafi, president I keshillit drejtues
2. Mohamed Ali Faramawy
3. Omar Dessouki
4. Ahmed Sharawi
5. Ahmed Sami

Përveç drejtorëve të parë, anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen prej Asamblesë së Aksionerëve në mbledhjen e zakonshme vjetore. Këshilli është përgjegjës për hartimin e politikave dhe mbikqyrjen e aktivitetit të Bankës. Me zgjedhjen e tyre dhe në fillim të çdo viti, Drejtorët do të informojnë më shkrim Komitetin për Konfliktin e Interesave në lidhje me të gjitha situatat aktuale ose potenciale të konfliktit të interesave në të cilat ata mund të jenë të përfshirë me Bankën. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë dhënie shpërblimi për anëtarët e Këshillit të Drejtuesve.

8.2 Në rast të ndonjë vendi bosh në Këshill si rezultat i vdekjes, dorëheqjes, pushimit, diskualifikimit, ose ndonjë shkakut tjetër, pasardhësit që zenë vendet bosh zgjidhen prej Drejtorëve aktualë në detyrë. Zëvendësuesit do të qëndrojnë në këtë detyrë deri në Mbledhjen e ardhshme të Zakonshme të Aksionerëve. Në rast se shumica e vendeve të anëtarëve të Këshillit është bosh si rezultat i vdekjes, dorëheqjes, pushimit, diskualifikimit, ose ndonjë shkakut tjetër, anëtarët e mbetur menjëherë thërrasin një Mbledhje të Zakonshme të Aksionerëve.

#### Mbledhjet e Këshillit të Drejtuesve

8.3 Mbledhjet e Këshillit të Drejtuesve mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrja në të cilat mund të jetë personalisht, me lidhje telefonike, me lidhje vizive, teleks, fax, postë elektronike, ose me mjete të tjera të ngjashme elektronike. Mbledhjet e Këshillit të Drejtuesve njoftohen dhe mbahen në vendin i cili caktohet prej Këshi lit.

8.4 Këshilli i Drejtuesve merr vendime me tre vota pro, me përjashtim të rasteve kur



me ligj kërkohet një numër më i madh votash pro. Në qoftë se në një mbledhje të Këshillit të Drejtuesve arrihet quorumi, Drejtorët e pranishëm mund ta shtyjnë mbledhjen për një moment të dytë pa njoftime të tjera derisa të arrihet quorumi.

8.5 Pas Mbledhjes së Zakonshme të aksionerëve, mbahet pa njoftim mbledhja vjetore e Këshillit të Drejtuesve. Orari dhe vendi i kësaj mbledhjeje vendoset prej Këshillit. Në këtë mbledhje, drejtorët, pasi të kualifikohen zgjedhin prej gjirit të tyre një Kryetar të Këshillit, zgjedhin dhe emërojnë të gjithë zyrtarët e tjerë që u lë në kompetencë ky Statut dhe që ata e mendojnë të arsyeshme dhe caktojnë Komitetet e parashikuara në këtë Statut.


8.6 Çdo vendim i cili lejohet ose kërkohet të merret në një mbledhje të Këshillit të Drejtuesve mund të merret pa organizuar një mbledhje në qoftë se të gjithë Drejtorët që duhet të merrnin pjesë në mbledhje miratojnë unanimisht me shkrim vendimin.

#### Nenpunesit ose Administratoret

8.7 Vendimet e përditshme të drejtimit të Bankës merren prej nenpunesve, të cilët emërohen prej Këshillit të Drejtuesve dhe përfshijnë drejtorin ekzekutiv, dhe/ose Zëvendës drejtorin, Sekretarin, Financierin, Nënpunësit e Kreditit, si dhe të gjithë nenpunesit e tjerë që do të vendosë Këshilli i Drejtuesve. Çdo zyrtar i zgjedhur ose i caktuar nga Këshilli i Drejtuesve mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Këshillit të Drejtuesve. Vendet bosh në këto detyra do të plotësohen prej Këshillit të Drejtuesve

#### Kompetencat e nenpunesve

8.8 Drejtori ekzekutiv. Drejtori ekzekutiv është Zyrtari i Parë Ekzekutiv i Bankës, merr pjesë në të gjitha mbledhjet e aksionerëve dhe Këshillit të Drejtuesve, bën drejtimin efektiv të të gjithë aktivitetit të Bankës, dhe kontrollon zbatimin e të gjitha vendimeve dhe urdhërave të Këshillit të Drejtuesve. Drejtori ekzekutiv ka kompetencë të nënshkruajë çeqe, urdhëra, kontrata qiraje, lajmërimet, propozime, dhe të gjitha dokumentat dhe instrumentat e tjera që kanë të bëjnë me biznesin e Bankës, dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentat që kërkojnë të kenë në të vulën e Bankës, me përjashtim të rasteve kur është e mundur ose e lejuar



prej ligjit të nënshkruhen dhe vulosen në mënyrë tjetër, dhe me përjashtim të rasteve kur nënshkrimi dhe vulosja e këtyre dokumentave shprehimisht i është deleguar prej Këshillit të Drejtuesve njërit prej zyrtarëve të tjerë të Bankës ose përfaqësuesve të saj. Presidenti kryen dhe të gjitha detyrat e tjera që i jep Këshilli i Drejtuesve dhe gjatë zhvillimit të punës së përditshme mund të delegojë të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër i Bankës.

- 8.9 Zëvendës Drejtori ekzekutiv. Zëvendës drejtori, në se ka një post të tillë, ose në qoftë se ka më shumë se një, Zëvendësdrejtoret në mënyrën e caktuar nga Këshilli i Drejtuesve, në mungesë ose pamundësi të drejtorit kryen detyrat dhe ushtrojnë të gjitha kompetencat e drejtorit, si dhe do të kryejnë ato detyra dhe ushtrojnë ato kompetenca që do t'u delegohen herë pas here prej Këshillit të Drejtuesve.
- 8.10 Sekretari. Sekretari, në se ka ndonjë, do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Drejtuesve dhe në të gjitha asambltetë e aksionerëve dhe do të mbajë shënim të gjitha procedurat e mbledhjeve të Bankës dhe të Këshillit të Drejtuesve në një libër të mbajtur për këtë qëllim dhe do të kryejë detyra të tilla të ngjashme për komitetet e përherëshme sipas nevojës. Sekretari bën eskuzivisht, ose kërkon bërjen e lajmërimit të mbledhjeve të të gjitha asambleve të Aksionerëve dhe mbledhjeve speciale të Këshillit të Drejtuesve, dhe do të kryejë të gjitha ato detyra të tjera që do t'i ngarkohen herë pas here nga Këshilli i Drejtuesve ose drejtori, nën mbikqyrjen e të cilit edhe do të jetë. Sekretari mban dhe ruan vulën e Bankës. Ai ka të drejtë të vendosë vulën e Bankës në të gjitha dokumentat dhe instrumentat që e kërkojnë vënien e saj dhe, kur bën një gjë e tillë e vërteton me nënshkrimin e sekretarit ose zëvendësit të tij. Këshilli i Drejtuesve mund të delegojë kompetencën e vërtetimit me anë të nënshkrimit dhe vendosjes së vulës edhe ndonjë personi tjetër.

## NENI 9 - KOMITETET

### Komiteti i Kontrollit

- 9.1 Banka do të ketë një Komitet Kontrolli i përbërë nga tre anëtarë që emërohen nga



Mbledhja e Përgjithshme e Aksionerëve.

- 9.2 Komiteti i Kontrollit është përgjegjës për të kontrolluar dhe mbikeqyrur procedurat kontabel të Bankës dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, mbikeqyre zbatimin e këtyre procedurave, dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet perkatese. Kontrollon zbatimin e rregulloreve dhe të akteve të tjera dhe i raporton Këshillit drejtues të Bankës, jep mendime për të gjitha problemet që i kerkohen nga Këshilli drejtues.
- 9.3 Komiteti i Kontrollit mbidhet jo më pak se tre herë në vite në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme kur një gjë të tillë e kërkon Këshilli i Drejtuesve të Bankës. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.
- 9.4 Komiteti i Kontrollit mund të kërkojë ndihmën e ekspertëve që emërohen nga Këshilli i Drejtuesve.
- 9.5 Asambleja Përgjithshme e aksionerëve mund të vendosë dhënie shpërblimi për anëtarët e Komitetit të Kontrollit.

#### Komiteti i Kreditit

- 9.6 Banka do të ketë një Komitet Krediti i cili do të përbëhet nga drejtori ekzekutiv dhe të paktën dy anëtarë të tjerë të caktuar nga Këshilli i Drejtuesve.
- 9.7 Komiteti i Kreditit është përgjegjës të ndjekë dhe zbatojë politikën e investimeve dhe dhënies hua sipas autorizimit nga Këshilli i Drejtuesve, të përcaktojë dhe ndjekë të gjitha procedurat e shkruara për zbatimin politikës së investimeve dhe dhënies hua, të miratojë të gjitha kreditë deri në limitin që ka përcaktuar Këshilli i Drejtuesve, t'i rekomandojë Këshillit për miratim kredi më të larta se këto limite, të bëjë rregullisht shqyrtime të portofolit të huave të Bankës në mënyrë që të sigurojë përputhjen me politikën e investimeve dhe dhënies hua të Bankës dhe të raportojë periodikisht përpara Këshillit të Drejtuesve në lidhje me sa më lart.
- 9.8 Komiteti i Kreditit mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj, ose dhe më shpesh si ta kërkojë volumni i punës që i paraqitet për shqyrtim.



### Komiteti i Konfliktit të Interesave

- 9.9 Banka ka një Komitet të Konfliktit të interesave i cili përbëhet nga tre anetare të emëruar nga Këshilli i Drejtuesve, të cilët nuk do të jenë anetare të Këshillit Drejtues . Komiteti i Konfliktit të Interesave do të ketë në përbërjen e tij një kryetar i cili nuk mund të jetë anëtar i keshillit drejtues dhe as i punësuar, dhe as ndonjë person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes profesional, material ose financiar në veprimtarinë e Aksionerit Themelues.
- 9.10 Komiteti i Konfliktit të Interesave është përgjegjës për të siguruar që aktiviteti dhe veprimtaria e Bankës do të mbeten konfidenciale dhe të ndara nga veprimtaria e biznesit të Aksionereve Themelues. Ai do të shqyrtojë dhe mbikqyrë zbatimin e Rregulloreve të Bankës që kanë të bëjnë me ndarjen e punëve të biznesit të Bankës nga ato të Aksionereve Themelues dhe për të raportuar përpara Këshillit të Drejtuesve mbi ndonjë situatë konflikti interesash aktuale ose potenciale midis e punëve të biznesit të Bankës dhe aktiviteti të drejtpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë të Aksionereve Themelues.
- 9.11 Në përputhje me ligjin, Komiteti i Konfliktit të Interesave do të marrë prej anëtarëve të Këshillit të Drejtuesve, drejtuesve dhe të punësuarve të Bankës të gjitha njoftimet në lidhje me konflikte intereseash potencialë ose aktualë që ata mund të kenë me Bankën. Ai do të shqyrtojë dhe mbikqyrë zbatimin dhe mbikqyrjen e plotë të ligjit dhe rregulloreve në lidhje me trajtimin e duhur të ndonjë situatë konflikti interesave dhe do të raportojë menjëherë përpara Këshillit të Drejtuesve në lidhje me trajtimin e duhur të ndonjë situatë konflikti interesash potenciale ose aktuale të paraqitur përpara Komitetit të Konfliktit të Interesave.
- 9.12 Komiteti i Konfliktit të Interesave mbledhet në mbledhje të zakonshme një herë në tre muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që ta kërkojë Kryetari i Këshillit të Drejtuesve

### NENI 10 - POLITIKAT DHE RREGULLORET E BRENDËSHME

Banka drejtohet e udhëhiqet nga rregulloret e brendshme të miratuara nga Këshilli i





Drejtuesve, të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë Statut dhe duhet të përcaktojnë: (a) strukturën e organizimit dhe të administrimit të Bankës, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, nënjësitë dhe funksionet e tyre, pozicionet mbikqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese; (b) detyrat e çdo drejtori të departamentit dhe të njësie që ai drejton dhe mbikqyr; (c) funksionet e Komitetit të Kontrollit dhe të Komiteteve të tjera të tjera të brendëshme të përherëshme; dhe (d) kufijtë e kompetencave të nenpuneseve (administratoreve) dhe punonjeseve të tjerë të Bankës që do të kryejnë veprimtari financiare në emër dhe për llogari të Bankës.

## NENI 11 - KONTABILITETI

- 11.1 Banka mban llogaritë e nevojshme dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat dhe metodat llogaritëse gjenden e saj financiare. Llogaritë dhe deklaratat financiare do të jenë në formën dhe përmbajtjen që cakton Banka e Shqipërisë në rregulloret e saj mbi standartet e kontabilitetit
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme, në Mbledhjet e saj të Rregullta vjetore do të caktojë një ose më shumë ekspertë të jashtëm të pavarur kontabël të cilët do të jenë ekspertë të autorizuar kontabël dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë.
- 11.3 Eksperti ose ekspertët do të kenë këto kompetenca: (a) kontrollon mbajtjen e llogarive, regjistrimin e operacioneve dhe veprimeve të Bankës; (b) përgatit raportin vjetor për gjendjen financiare (bilancin, llogarinë fitime e humbje, dhe dokumente të tjera të këtij lloji) të Bankës dhe jep mendime për vërtetësinë dhe gjendjen financiare të Bankës; (c) informon Këshillin e Drejtuesve të Bankës, Asamblenë e Përgjithshme dhe Bankën e Shqipërisë për çdo paregullsi a të metë të vëzhguar gjatë operacioneve, veprimeve, procedurave, regjistrimeve, ose llogarive të Bankës të cilat mund t'i sjellin asaj humbje materiale; dhe (d) shqyrton përpikmërinë e revizionit të brendshëm, kontrollon praktikën dhe procedurat dhe bën rekomandime për përmirësime.



## NENI 12 - AKSIONET

### Certifikatat e Aksioneve

- 12.1 Aksionet e Bankës përfaqësohen nga një certifikatë ose mund të jenë të pacertifikuara. Certifikatat do të nënshkruhen nga, ose në emër të shoqërisë, prej Presidentit ose nga Zëvendës Presidenti, Financieri ose Ndihmësi i Financierit, ose Sekretari ose Ndihmësi i Sekretarit të Bankës dhe mund të vulosen me vulën e Bankës.

### Certifikatat e Humbura

- 12.2 Këshilli i Drejtuesve mund të urdhërojë emetimin e një certifikate të re, ose certifikatave për aksione të pacertifikuara në vend të ndonjë certifikate ose certikatave të emetuara nga shoqëria dhe të deklaruara të humbura ose të papërdorshme. Kur bën autorizimin e emetimit të një certifikate të re, ose aksione të pacertifikuara, Këshilli i Drejtuesve mund të parashikojë të gjitha kushtet dhe procedurat që ai i quan të nevojshme si dhe mund të këkojë pagesën e një sasi parash në atë shumë e cila mund të përdoret si një dëmshpërblim kundra cdo pretendimi që mund të bëhet kundër Bankës në lidhje me certifikatën e konsideruar të humbur, ose të papërdorshme.

### Transferimi i Certifikatave

- 12.3 Me dorëzimin në Bankë ose tek agjenti i transferimit i Bankës i një certifikate të aksioneve të nënshkruara në mënyrën e duhur ose të shoqëruara nga provat e duhura të pasimit, kalimit të pronësisë, ose kompetencën për të transferuar, Banka ka për detyrë të emetojë një certifikatë të re personit të titulluar, të shfuqizojë certifikatën e vjetër dhe të regjistrojë kryerjen e transaksionit në librat e tij.

### Përcaktimi i Datës së Regjistrimit

- 12.5 Për të bërë të mundur që Banka të përcaktojë personat që kanë të drejtën e lajmërimit dhe të votimit në mbledhjet e aksionerëve, në mbylljet e tyre, për të shprehur miratimin ose kundërshtimin e tyre për projekt vendimet e marra me shkrim pa marrë pjesë në mbledhje, ose që kanë të drejtë të marrin pagesën e dividendit ose shpërndarjeve të tjera, apo shpërndarjen e ndonjë të



drejte, ose që janë të titulluar të ushtrojnë ndonjë të drejtë në lidhje me ndonjë ndryshim, konvertim ose shkëmbim të aksioneve ose për qëllim të ndonjë veprimi tjetër të ligjshëm, Këshilli i Drejtuesve mund të fiksojë më parë një datë për kryerjen e regjistrimeve. Kjo datë nuk mund të vendoset me shume se 50 ditë dhe më pak se 10 ditë nga data e mbajtjes së ndonjë mbledhjeje dhe jo më pak se 50 përpara kryerjes së ndonjë veprimi tjetër. Kur përcaktimi i numrit të aksionerëve me të drejtë për t'u lajmëruar ose për të votuar në një asamble të aksionerëve është bërë sipas këtij neni, ky numër do të zbatohet edhe në mbledhjet e shtyra, me përjashtim të rasteve kur Këshilli i Drejtuesve ka caktuar një datë të re regjistrimi për takimin e shtyrë.

#### Aksionerët e Regjistruar


- 12.6 Banka ka të drejtë t'u njohë personave të regjistruar në librat e saj të drejtën eskuzive si pronarë të aksioneve për të marrë dividendët, për të votuar si pronarë, si dhe të jenë të detyruar të përgjigjen për thirrjet dhe rillogaritjet për personat e regjistruar në librat e tyre si pronarë të aksioneve, dhe nuk do të jenë të detyruar të njohin ndonjë pretendim ose interes tjetër për këtë aksion ose aksione, edhe nëse do të ketë kenë të drejtë mbi ta, më përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

#### Lista e Aksionerëve

- 12.7 Me kërkesë të cilitdo aksioner, përpara apo gjatë një Asambleje të Aksionerëve, do të përgatitet një listë e aksionerëve të Bankës, sipas datës së fundit të regjistrimit, e vërtetuar prej nëpunësit kompetent të Bankës. Nëse kundërshtohet e drejta e votimit në ndonjë mbledhje, inspektorët e zgjedhjeve, ose personi që kryeson mbledhjen, kërkon përgatitjen e kësaj liste për ta pasur si provë në lidhje me të drejtën e personave të cilëve u kundërshtohet votimi në atë mbledhje; të gjithë ata persona që paraqiten si aksionerë në këtë listë kanë të drejtë të votojnë në atë mbledhje.

### NENI 13 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Dividentët



- 13.1 Dividentët mund të deklarohen në përputhje me ligjin prej Këshilli të Drejtuesve në cilëndo prej Asambleve të Zakonshme ose të Jashtëzakonshme. Dividentët mund të paguhën me para në dorë, në natyrë, ose me aksione kapitali, ose në letra me vlerë të Bankës, apo edhe pasurie të saj, duke përfshirë edhe letra me vlerë të ndonjë banke tjetër, gjithnjë në zbatim të ligjive të zbatueshme
- 13.2 Këshilli mund herë pas here, përpara pagesës së një dividenti, të vendosë mënjane prej fondit të dividentëve atë shumë që ai e mendon të drejtë si një fond rezervë për t'i përdorur për pagesa të gjërave të paparashikuara ose për të barazvlerësuar dividentë, për të mirmbajtur dhe riparur ndonjë pronë të Bankës, ose për ndonjë qëllim tjetër të cilin Drejtorët e quajnë të arsyeshëm. Drejtorët mund të ndryshojnë apo edhe të mbyllin cilindo prej këtyre fondeve rezervë në mënyrën në të cilën u krijuan.

#### Viti Financiar

- 13.3 Viti financiar i Bankës është viti kalendarik, me perjashtim të rasteve kur Këshilli i Drejtuesve vendos ndryshe.

#### Vula

- 13.4 Vula e shoqërisë do të ketë të shkruar brenda emrin e Bankës, vitin e formimit dhe fjalët "Vula e Shoqërisë". Vula do të përdoret si në dokumenta origjinale dhe në kopje si dhe në ato të riprodhuara në mënyra të tjera.

### NENI 14 - NDRYSHIMET DHE SHITESAT

Ky Statut mund të ndryshohet ose shfuqizohet dhe në vend të tij të miratohet një Statut i ri në një Mbledhje të Jashtëzakonshme me anë të votës pro të pesëdhjetë për qind plus një (50% + 1) të votave të të gjithë aksionerëve, me kusht që në lajmerimin e bërë për mbledhjen të jenë të përfshirë edhe njoftimi në lidhje me ndryshimin, shtesën apo shfuqizimin. Të gjitha ndryshimet hyjnë në fuqi në momentin e regjistrimit të tyre në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.



## NENI 15 - SHPËRNDARJA

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve në një Mbledhje të Jashtëzakonshme të saj mund të vendosë për mbylljen e aktivitetit të Bankës. Në këtë mbledhje duhet të jetë prezent ose i përfaqësuar quorumi i kërkuar. Vendimi merret me të njëjtin numër votash pro të mbajtësve të aksioneve që duhen në zgjedhjen e Drejtuesve me kusht që në lajmërimin e bërë duhej të përfshihej propozimi i shpërndarjes.

## NENI 16 - FILLIMI I AKTIVITETIT

Aktiviteti i Bankës fillon në datën e marrjes së licensës së përherëshme nga Banka e Shqipërisë.

## NENI - DISPOZITE PERFUNDIMTARE

Të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë Statut rregullohen nga dispozitat e Ligjit Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", dhe nga Ligji Nr. 8365 datë 2.07.1998, "Për Bankat në Republikë e Shqipërisë" në formën aktuale dhe me ndryshimet që mund tu bëhen.

Ky Statut është nënshkruar sot më datë 5/2002 Aksionerve Themelues:

Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi

Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi

Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi



*S. Selvi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 2030 REP  
NR 23 KOL

VERTETIM




Sot ne date 03.06.2002 para meje noteres ne dhomen e Noterise Tirane , u paraqit personalish perfaqesues me prokuren nr 3943 velli 4, date 5.3.2002 I aksionereve themelues te Bankes se Kreditit te Shqiperise:

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi

Tarek Mohamed Soliman I cili deklaroi se akti I mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre dhe shpreh vullnetin e lire e te plote te perfaqesuarve prej tij, dhe atij vete, e nenshkruan kete akt para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



NOTERE  
*Shpresa Kusbi*



## VENDIM

Sot më 05.02.2007 në Tiranë u mbajt Mbledhja e Jashtëzakonshme e Credit Bank of Albania (CBA). Në mbledhje ishin të pranishëm të tre aksionerët e bankës.

- 1- Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi
- 2- Nasser Mohamed Abdumohsen Al – Kharafi
- 3- Fauzi Mohamed Abdumohsen Al – Kharafi

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve u mbledh me kërkesë të Drejtorët e Bordit të CBA. Në mbledhje u diskutua zmadhimi i kapitalit të bankës në 1.800.000 dollarë.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve pas diskutimit të kërkesës së mësipërme duke e konsideruar të përshtatshme unanimisht


## VENDOSI

1 - Zmadhimin e kapitalit të bankës në 1.800.000 dollarë amerikan – duke emetuar 1800 aksione shtesë, me vlerë nominale të një aksione prej 1000 USD

- Kontributi në të holla i aksionerëve do të jetë si më poshtë:

- 1- 600 aksione (gjashtëqind) në emër të Jassim Mohamed Abdulmohsen Al – Kharafi;
- 2- 600 aksione (gjashtëqind) në emër të Nasser Mohamed Abdulmohsen Al – Kharafi;
- 3- 600 aksione (gjashtëqind) në emër të Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al – Kharafi.

2 – Kapitali i përgjithshëm i nënshkruar i Bankës do të jetë në vlerën 11.100.000 USD (njëmbëdhjetë million e njëqind mijë dollare amerikan) dhe numri i aksioneve të



të autorizuarra do të jetë 11 100 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind) duke pasur një vlerë nominale prej 1000 USD për çdo aksion.

- Të caktohet Mr. Kamal Abdel Moneim për të depozituar vendimin më Gjykatën e Rrethit Gjyqsor të Tiranës dhe ndryshimet përkatëse në Zyrën e Regjistrimit Tregtar.

**AKSIONERËT E SHOQËRISË ANONYSMU**  
**“Banka e Kredit Shqiptar”**

**Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi**

**Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi**

**Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2324 Rep.

Nr. 452 Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 12 / 03 /2007, para meje noteres Neriman Marika, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë me seli në Rrugën Ded Gjon Luli, u paraqit personalisht Z. **Loyal Jassim Mohamed Al-Kharafi**, me shtetësi kuvaitiane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. 366041200921, i cili ka hartuar dhe nënshkruar këtë dokument jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit. Teksi i mësipërm ju bë i njohur në gjuhën angleze prej meje noteres.

N O T E R E

Neriman MARIKA

*Notere  
Neriman Marika*

3 AXHAR KESH  
17 05 2002  
*[Signature]*

X  
27845

**KERKESE**

**GYKATES SE SHKALLES SE PARE  
RRETHIT TIRANE  
RREGJISTRITREGTAR**

**KERKUESI:** Nasser M.A.Al – Kharafi me cilesine e kryetarit te keshillit drejtues te “Bankes se Kreditit te Shqiperise” Sh.A. perfaqesuar me prokure te posacme nr. 3943 vell 4, date 5.03.2002 nga Tarek Mohamed Soliman.


**OBJEKTI:** Rregjistrim ne Rregjistrin Tregtar te kesaj Gjykate, Shoqerise “Banka e Kreditit te Shqiperise” ShA.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7632, date 04.11.1992 “Per Pjesen e Pare te Kodit Tregtar” Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993 “Per Rregjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare” dhe Ligji Nr. 8365, date 2.7.1998 “Per Bankat ne Republikon e Shqiperise”

Sot me date, \_\_/\_\_/2002, une, duke u bazuar ne (kompetencat si kryetar i keshillit Drejtues) i kerkoj Gjykates se Shkalles se Pare Rrethit Tirane te rregjistroje ne Rregjistrin Tregtar te kesaj gjykate shoqerine “ Banka e Kreditit te Shqiperise” ShA.

Emri i Shoqerise eshte “Banka e Kreditit te Shqiperise” ShA. Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise “Banka e Kreditit te Shqiperise” eshte e pakufizuar.

Objekti i Shoqerise eshte kryerja e aktivitetit te sherbimeve bankare dhe financiare ne perputhje me Ligjin Nr. 8365 (date 2.7.1998). “Per Bankat ne Republikon e Shqiperise” ne formen aktuale dhe me te gjitha ndryshimet qe mund t’i behen. Specifikisht, Shoqeria mund te kryeje keto aktivite: (a) pranimin e depozitave (ne formen e depozitave pa afat, me afat ose formave te tjera te depozitave), per te cilat paguan ose jo interes; (b) dhenie kredish, duke perfshire kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua te fondeve dhe blerje ose shitje per llogari te saj ose per llogari te klienteve te instrumenteve te tregut monetar (duke perfshire nder te tjera ceqet, kambialet dhe certifikatat e depozitave), te letrave me vlere te borxhit; te kontratave te se ardhmes dhe kontratat “e mundesive”, qe lidhen me letrat me vlere te borxhit ose normat e interesit; te instrumentave te normes se interesit; (d) kryerjen e sherbimeve te pageses; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve te pageses (duke perfshire nder te tjera pagesat me karte, me ceqet e udhetarit dhe ceqet e bankierit); (f) ndermjetesin per operatione monetare duke perfshire valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e sherbimeve si agent financiar, ose keshilltar financiar si dhe te gjitha aktivitetet financiare qe do te percaktohen ne licensen perfundimtare te Bankes se Shqiperise.



Adresa e selise se Shoqerise eshte ne rr "Perlat Rexhepi", godina e administrates se grupit Al-Kharafi, kati 1re & 2te Tirane, Shqiperi.

Kapitali total i Bankes eshte shtate qind milion (700,000,000) leke, dhe numri I aksionereve te autorizuar ne te cilet do te ndahet ky kapital eshte 35 000 (tridhjetë e pese mije) aksione me nje vlere nominale prej njeqind (20 000) lek per aksion. I gjithë kapitali aksioner I Shoqerise I perket plotesisht aksionereve themelues ne menyre te barabarte qe jane:

Jassim Mohammed Abdulmohsen Al – Kharafi

Nasser Mohammed Abdulmohsen Al – Kharafi

Fauzi Mohammed Abdulmohsen Al – Kharafi.

Keshilli I Drejtuesve te Shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" perbehet nga keta anetare:

1. Nasser M.A.Al – Kharafi, kryetar I keshillit drejtues
2. Mohamed Ali Faramawy
3. Omar Dessouki
4. Ahmed Sharawi
5. Ahmed Sami

Drejtore ekzekutiv eshte zgjedhur Shahin Serag El – Din.

Kerkesa bazohet ne ligjin Nr. 7632, date 04.11.1992 "Per Pjesen e Pare te Kodit Tregtar", ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare" dhe ligjin Nr. 8365, date 2.7.1998 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise" ndaj jemi ne shpresen qe do te pranohet.

**KERKUES**

**Tarek Mohamed Soliman**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**

Nr. 1942 Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Col.

**VERTETIM**

Sot, me date 27/05/2002, ne Zyren e Noterise Tirane, prane meje Noteres, u paraqit personalisht Tarek Mohamed Soliman, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda pasi verifikova pasaporten e tij, I cili me deklaroi se e ka perpiluar kete kerkesa jashte Zyres se Noteres, me vullnetin e tij te lire, kerkesa te cilen e nenshkroi perpara meje, dhe une e vertetoj ate sipas kerkesave te ligjit.



Notere  
Shpresa Kurti

27845/15

Z. B. Musa  
04.02.07. 2007

*P. Musa*

# CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA  
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

## KËRKESË

**KËRKUES:** Shoqëria Tregtare “ Banka e Kreditit Shqiptar” Sh.a përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, Z. Kamal Abdel Moneim, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

**OBJEKTI:** Depozitimi i Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të të Shoqërisë “Banka e Kreditit Shqiptar” Sh.a., datë 05.02.2007 për miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve

**PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR**

*60 depozitimi i vendimit*  
*04.17.04.07*

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare “Banka e Kreditit Shqiptar” Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 27845 datë 03.06.2002 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

*BA-56*

Me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë paraqes këtë kërkesë për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë datë 05.02.2007. Meqë në këtë vendimi, Aksionerët e shoqërisë “Banka e Kreditit Shqiptar” Sh.a, ka vendosur të zmadhojë kapitalin e saj nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve. Kapitali i shoqërisë pas këtij zmadhimi do të jetë 11.100000 dollarë dhe numri i aksioneve do të jetë 11.100 me një valutë prej 1000 dollarë aksioni

*Nr. Rep. 00446328*  
*05.02.2007*  
*05.02.2007*  
*Vendim 04.5.2.07*

Ky vendim është marrë në përputhje me aktet e themelimit të shoqërisë dhe të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë Tregtare “Banka e Kreditit Shqiptar” Sh.a, të datës 05.02.2007, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të hollatë aksionerëve.

*A. J. Jakoni*

**KËRKUESI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Kamal Abdel Moneim**



**KËRKESË**

27845/4

3- h. Dajpa  
10.02.2006  
KORRINT 2006

**KËRKUES:** Shoqëria Tregtare "BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISËS" Sh.a., përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Kamal Abdel Moneim i ngarkuar për depozitimin edhe sipas Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

**OBJEKTI:** Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të datës 08.05.2006, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve.

**PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR**

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

Te depozitohet kërkesa e asamblesës së aksionerëve të datës 8/5/2006

Shoqëria Tregtare "BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISËS" Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 27845, datë 03.06.2002 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

2/ Dokumenti i referencës dt 8/10/5/2006

Me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a. paragesë këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, të datës 08.05.2006. Aksionerët e Shoqërisë janë përfaqësuar në këtë Asamble nga Z. Kamal Abdel Moneim, sipas prokurës së lëshuar prej tyre për përfaqësim në të gjitha çështjet e shoqërisë, prokurë e cila gjendet e depozituar në skedën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Prokurë e lëshuar për transferimin e depozitimit të kësaj kërkesë me datën 24/9/06 dt 18/5/06

Me anë e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, të datës 08.05.2006, aksionerët e shoqërisë kanë vendosur të zmadhojnë kapitalin e shoqërisë nëpërmjet kontributit në para të tyre. Gjithashtu sipas vendimit është ngarkuar Z. Kamal Abdel Moneim për depozitimin e vendimit në gjykatë.

28/9/2006  
Kryetari  
Dajpa


Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISËS" Sh.a., datë 08.05.2006.

**KËRKUES**

**DREJTORI EKZEKUTIV**  
Përfaqësues i Shoqërisë

K-A-M

Kamal Abdel Moneim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2323 Rep.

Nr. - Kol.



V È R T E T I M

Sot më datë 12/03 /2007, para meje noteres Neriman Marika, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë me seli në Rrugën Ded Gjon Luli, u paraqit personalisht Z. **Kamal Abdel Moneim**, lindur më 15.05.1940, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 2202003, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Bankës së Kreditit të Shqipërisë Sh.a., i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit. Teksi i mësipërm ju bë i njohur në gjuhën angleze Z. Kamal Abdel Moneim prej meje noteres.

NOTERE

Neriman MARIKA

*Notere*  
*Neriman Marika*



27 04/03

3 Arlene Celso  
14 TETOR 2005

**KERKESE  
PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK**

**Kerkuesi:** "BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE" (CBA) sha , perfaqesuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Kamal Abdel Moneim.

**Objekti:** Depozitim prane Rregjistrin Tregtar te akteve te personit Juridik


**Baza Ligjore:** Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe ligji 7667 date 28.01.1993, "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

**Per kompetence:** **GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
TIRANE**

"BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE" (CBA) sha eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.27845 date 03.06.2002, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Me vendimin e dates 23.06.2005 Aksioneret qe zoterojne 100% te aksioneve te Bankes se Kredit te Shqiperise (CBA) sha, zoterojnje: 1. Jassim M.A. Al-Kharafi; 2. Nasser M.A. Al-Kharafi; 3. Fawzi M.A. Al-Kharafi; kane vendosur:

- Miratimin e bilancit te dates 31 Dhjetor 2004
  - Miratimin e Auditimit te Jashtem per vitin e kaluar i cili perfundoj ne 2005 Aksioneret rane dakort te caktojne kompanine "KPMG Albania" shpk si Auditor te Jashtem te bankes, e cila do te jete pergjegjese per auditimin allogarive dhe do te pergatise bilancin dhe raportin financiar kundrejt nje shume prej 10.500 Euro perjashtuar TVSH-ne.
  - Ndryshimin e nenit 9 "Komitetet" ne Statutin e Bankes se Kredit te Shqiperise. Abrogohet "Komiteti i Konfliktit te Interesave" dhe pergjegjesisite dhe detyrimet e ketij komiteti ti trasferohen "Komitetit te Auditimit".
  - Emerimin e antareve te rinj te Komitetit te Auditimit Asambleja e Aksionereve ka rane dakort te emeroje te poshte permendurit ne Komitetin e Auditimit
1. Z. Drini Salko kryetar
  2. Z. Benet Beci antar
  3. Znj. Elvana Sharkaj antare
- Ngarkohet z. Kamal Abdel Moneim te depozitoje kete vendim ne Gjykatën e Tiranës.

**KERKUESI**  
**"BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE" (CBA) sha**  
**Drejtori Ekzekutiv**  
**Kamal Abdel Moneim**



27845/2

30 MARS 2004  
3 M Dapp  
03 2004  
[Signature]

**KERKESE  
PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK**

**Kerkuesi:** "Banka e Kreditit te Shqiperise" sha .

**Objekti:** Depozitim prane Rregjistrin Tregtar te akteve te personit Juridik

**Baza Ligjore:** Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Trgtare" dhe ligji 7667 date 28.01.1993, "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

**Per kompetence:** GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

*Jo de pro rata...*  
*11 dt. 29.8.2003*

Shoqeria "Banka e Kreditit te Shqiperise" eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.27845 date 03.06 2002 te gjykates se shkallles se pare Tirane, me aksionere

1. Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
2. Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi
3. Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi

*11.2.2004*  
*allanone...*  
*Banka e Shqiperise*

Shoqeria e ka seline ne rrugen: "Perlat Rexhepi,, Al-Kharafi Group Administration Building, Kati I &2, me kapital aksioner 700.000.000 (shtate qind milion) leke.

Me date 29.08.2003 me kerkese te Bordit te Drejtoreve eshte zhvilluar mbledhja e jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" sha e perbere nga aksioneret:

Jassim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi, Nasser Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi, Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi e cila ne unanimisht vendosi:

*11.2.2004*  
*Banka e Shqiperise*  
*17/6/2003*

- 1 Te ndryshoje nenin 6 te statutit te shoqerise, duke ndryshuar kapitalin e bankes nga leke ne dollare amerikane dhe konkretisht; 700.000.000 (shtate qind milion) leke qe eshte kapitali fillestar i shoqerise duke u konvertuar ne dollare sipas kursit te kembimit valutor te dates 16.05.2002 jane te barasvlefshme me jane te barasvlefshme me 5.000.000 USD (pese milion dollare amerikane.)
- 2 Te rrise kapitalin total te bankes nga 5.000.000 USD (pese milion dollare amerikane) ne 6.000.000 USD (gjashte milion dollare amerikane) te ndara ne 6.000 aksione me vlere nominale prej 1.000 USD secila. Kapitali i aksioneve te bankes eshte i teri i atribuar aksionereve themelues.
- 3 Caktohet Z. kamal Abdel Moneim per te depozituar kete vendim ne gjykaten e shkalles se pare Tirane per te bere ndryshimet perkatese ne zyrat e rregjistrin tregtar.

*11.2.2004*  
*Banka e Shqiperise*  
*dt 3.3.2004*

Me date 11.02.2004 me kerkese te Bordit te Drejtoreve u mbajt Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" ne te cilin moren pjese te tre aksioneret te cilet vendosen unanimisht:

- 1 Te rrisin kapitalin e bankes me 1.800.000 USD (nje milion e tetqind mije dollare

*[Signatures]*



amerikane. Shuma totale e kapitalit te bankes eshte 7.800.000 USD ( shtate milion e teteqind mije dollare amerikane) dhe numri i aksioneve te autorizuar eshte 7.800 (shtate mije e teteqind) duke pasur nje vlere nominale prej 1.000 USD ( njemije dollare amerikane ) per aksion. Kapitali i aksioneve te bankes eshte i teri i atribuar aksionereve themelues.

Te caktoje z. Kamal Abdel Moneim te depozitoje kete vendim ne gjykatën e shkalles se pare Tirane duke u bere ndryshimet respektive ne regjistrin tregtar.

Bazuar ne sa me siper si dhe ne ligjin nr. 7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne ligjin nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare parashtrroj kete kerkese per depozitim ne regjister tregtar te dy vendimeve te mesiperme te mbledhjes se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise "Banka e Kreditit te Shqiperise" sha.

### KERKUESI

Kamal Abdel Moneim

*Kamal Abdel Moneim Ali Dwi.*  
*K.A.M.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE

NR. 582 REP

### VERTETIM

Sot., me date 29/03/2004, para meje noterit Fatbardha Tepe u paraqit personalisht z. Kamal Abdel Moneim , i njohur personalisht prej meje, person madhor me zotesi te plote per te vepruar i cili me deklaroi se kete kerkese drejtuar gjykates se shkalles se pare Tirane e ka perpiluar ne perputhje me vullnetin e tij te lire dhe te plote.

Une noteri pasi i lexova tekstin e kesaj kerkese ne prani te perkthyesit te gjuhes angleze Eglin Sakiqi, e nenshkroi ate rregullisht, dhe une noteri e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.



27845/1  
24.02.2003

J B Mucas  
24 02 2003

**KERKESE** : SHOQERIA "Banka e Kreditit te Shqiperise"Sh.a. e perfaqesuar  
Me prokure te posacme nga Z. Tarek Mohamed Soliman.

**OBJEKT**: Depozitim i vendimit te Bordit te Drejtoreve te "Bankes se Kreditit te Shqiperise"Sh.a. ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 Janar 1999

**PERPARA**: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
TIRANE



Me vendimin e Gjykykates se rrethit Tirane nr. 27845 date 3/6/2002 eshte themeluar "Banka e Kreditit te Shqiperise"sh.a, me objekt veprimtarie:

Objekti i bankes eshte kryerja e aktivitetit te sherbimeve bankare dhe financiare ne perputhje me Ligjin Nr. 8365, date 2.7.1998. Per bankat ne Republiken e Shqiperise"ne formen aktuale dhe me te gjitha ndryshimet qe mund t'i behen. Specifikisht, Banka mund te kryeje keto aktivite: a) pranimi e depozitave, per te cilat paguan ose jo interes; (b) dhenie kredish, duke perfshire kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua e fondeve dhe blerje ose shitje per floghari te saj a per flogari te klienteve te instrumenteve te tregut monetar (duke perfshire nder te tjera ceqet kambialet dhe certifikatat "e mundesive", qe lidhen me letrat me vlere te borxhit ose normat e interesit; (d) kryerjen e sherbimeve te pageses; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve te pageses (duke perfshire nder te tjera, pagesat me karte, ceqet e udhetarit dhe ceqet e bankierit); (f) ndermjetesin per operacione monetare duke perfshire valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e sherbimeve si agjent financiar, ose keshilltar financiar si dhe te gjitha aktivitetet financiare qe do te percaktohen ne licensen perfundimtare te Bankes se Shqiperise.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" eshte vendosur:

Me vendimin e Bordit te Drejtoreve date 01.02.2003 te pranohet doreheqja e zoterise Shahin Serag El Din dhe te emrohet Z. Kamal Abdel Moneim si Zevendes Drejtor i Bankes.

Sa me siper i kerkoj Gjykykates:

Te pranoj kerkesen per depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te vendimit te bordit "Bankes se Kreditit te Shqiperise"Sh.a.

Bashkalidhur kerkeses jane:

- I. Vendimi i Bordit.

**KERKUES**

Perfaqesuesi i Bankes  
Z. Tarek Mohamed Soliman

*T. Soliman*  
Tarek Mohamed Soliman



BANKA E SHQIPERISE  
BANK OF ALBANIA

3/3

**DEPARTAMENT I MBIKEQYRJES**

**Sektori i Licencimit dhe Rregullimeve Bankare**

Nr. 843/5 Prot.

Tirane, me 24 04. 2001

**Lenda: Dhenja e miratimit paraprak per licencimin e Bankes Tregtare te Kuvaitit (te propozuar)**

**Per: Z. Tarak M. Soliman Ahmed  
MAK – ALBANIA, Sheshi "ITALIA"  
TIRANE**


Keshilli Mbiqyres i Bankes se Shqiperise ne vendimin e tij nr.33, date 18.04.2001, pasi morri ne shqyrtim kerkesen tuaj, vendosi :

**"Të japë miratimin paraprak të licencës për të ushtruar aktivitet bankar Bankës Tregtare të Kuvaitit (në formim) në përputhje me rregulloren "Per dhenjen e licences per te ushtruar veprimtari bankare ne Republiken e Shqiperise" dhe ligjin nr 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".**

Keshilli Mbiqyres i Bankes se Shqiperise, kerkon lidhur me aplikimin e paraqitur, nga Banka Tregtare e Kuvaitit (e propozuar), te paraqise, edhe nje here, planbiznesin e parashikuar te bankes per tre vitet e para te veprimtarise se saj, bazuar mbi studimit e treguesve me te fundit te zhvillimit te ekonomise dhe sistemit bankar shqiptar.

Ju urojme pune te mbare ne pergatitjet per fillimin e veprimtarise bankare.

Fatos IBRAHIMI  
ZV.GUVERNATOR I PARE



Text of Translation

**FIN/2002/T-268**

**14 Maj 2002.**

**Banka Kombetare e Kuvajtit S.A.K.  
Selia Qendrore  
Kuvajt**

**Te Nderuar Zoterinj,**

**SUBJEKTI: TRANSFERTE PARASH**

*Ju lutemi transferoni me telex shumen e plote US\$ 5,000,000/- (Vetem pese milion US\$) ne llogarine e meposhtme:*


*Emri i llogarise : BANKA E SHQIPERISE  
Emri i bankes : Federal Reserve Bank of New York  
New York, U.S.A.  
Swift Code : FRNYUS33  
Numri i llogarise : 021088315 ALBAN*

*Ju lutemi shkruani ne transferten me telex se shuma e lartpermendur perfaqeson Pagesen per bllokimin e kapitalit te bankes se re "BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE".*

*Ju lutemi debitori shumen e mesiperme se bashku me shpenzimet bankare & shpenzimet e bankes(ve) korrespondente neqofte se ka ndonje te tille, ne llogarine tone nr. 000 324566 03 08 me ju.*

*Duke ju falenderuar, ne mbetemi ne pritje.*

*I Juaji singerisht,  
Per M.A.Kharafi & Sons Co. W.L.L.*

  
KALIOPE PULA  
PERKTHYESE LEGALE  
SWORN TRANSLATOR  
TEL 0382128428



RECEIVED  
27/05/02

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568  
• Fax: ++355 4 223558 • Website [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org) • E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Departamenti i Mbiqyrjes

## VERTETIM


Me ane te ketij dokumenti vertetojme se per llogari te Bankes se Kreditit te Shqiperise eshte depozituar ne Banken e Shqiperise ne nje depozite te bllokuar, shuma prej 5 milion USD, me date valute 16.05.2002. Kjo shume e derdhur ne nje llogari te bllokuar ne Banken e Shqiperise, do te sherbeje si garanci per kapitalin e bankes se re ne formën Banka e Kreditit e Shqiperise, e cila ka aplikuar per marrjen e licences per te ushtruar aktivitet bankar ne Republikën e Shqiperise.

Kursi i kembimit ne datën 16.05.2002 ka qene 1 USD = 144.77 leke.

E leshojme kete vertetim me kerkesen e vetë te interesuarit.

Eris Sharxhi

Zv. Drejtor i Departamentit



3/5

30/04/02



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568  
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

Departamenti i Mbiqyrjes

Numer Protokolli: 122P/1

Tirane 30. PRILL 2002

Për : **BANKEN TREGTARE TE KUVAITIT (ne formim)**

Në vemendje të: **Z. Tarak M. Soliman Ahmed**  
**MAK - ALBANIA**  
**SHESHI "ITALIA"**  
**TIRANE**

Lenda: **Kerkese per licencimin e bankes**

I nderuar Z. Soliman,

Ne vijim te korespondences per marrjen e licences per te filluar veprimtarine bankare, nepermjet letres tuaj te dates 24.04.2002, u njoftuam per emrin e ri qe keni menduar t'i vini bankes ne formim:

"Banka e Kreditit te Shqiperise" ne anglisht "Credit Bank of Albania".

Ne anen e kesaj letre ju njoftojme se Banka e Shqiperise nuk paraqet ndonje kundersizim per kete emertim.

Ne pritje te plotesimit te dokumentacionit per licencimin e bankes suaj, ju kujtojmë se jeni ne tejkalim te afateve te vlefshmerise se miratimit paraprak te dhene.

Fatos Ibrahimi

Zv.Gubernurator i pare



REPUBLIC OF ALBANIA  
NOTARY CHAMBER OF TIRANA

No. 2324 Rep.

No. 452 Col.


CERTIFICATION

Today on 12 / 03 / 2007, before me the Notary Neriman MARIKA, member of the Notary Chamber of Tirana seated at Ded Gjon Luli Street, has appeared personally Mr. **Loyal Jassim Mohamed Al-Kharafi**, of Kuwaiti citizenship, of full legal age and capacity to act, bearer of the personal ID 366041200921, who has compiled and undersigned the above document outside of this notary office, signed with his full and free consent and me the notary have certified it in conformity with the law. This text has been translated in English from me the notary.

NOTARY

Neriman MARIKA

*Neriman Marika*  
Neriman Marika



## **DECISION**

Today on 05/02/2007 in Tirana was held a extraordinary meeting of the Credit Bank of Albania (CBA). In the meeting took part three founding shareholders of the bank.

- 1 -Jassim Mohamed Abdulmohsen Al— Kharati
- 2 -Nasser Mohamed Abdulmohsen Al— Kharafi
- 3 -Fauzi Mohained Abdulmohsen Al — Kharafi

The extraordinary meeting of the shareholders assembly was called upon the request of the Directors Board of CBA. A request regarding the increasing the capital of the bank by USD 1 800 000/ - was discussed.

The extraordinary meeting of the shareholders assembly, after the discussions of the above request, considered convenient and unanimously

## **DECIDED**

1-To increase the capital of the bank by USD 1 800 000/ - by issuing 1 800 additional shares Capital having a nominated value of USD 1 000 per share

- It is contributed by the founding shareholders in cash as follows”
  - 1 -600 shares (six hundred) in the name of Jassim Mohamed Abdulmohsen Al -Kharafi
  - 2 -600 shares (six hundred) in the name of Nasser Mohamed Abdulmohsen Al — Kharati
  - 3 -600 shares (six hundred) in the name of Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al— Kharafi



2 - The total subscribed share capital of the bank will be USD 11 100 000/- (United State Dollars eleven million one hundred thousand) and the number of authorized shares will become 11 100 (eleven thousand one hundred shares) having a nominal value of USD 1000 per share.

- To appoint Mr. Kamal Abdel Moneim to deposit the decision to the Court of Tirana District and respective changes in the Office of Commercial Register.

**THE SHAREHOLDERS OF ANONYSMU COMPANY**  
**"The Credit Bank of Albania"**

**Jassim Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi**



**Nasser Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi**



**Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al - Kharafi**



X

CBA

19 MAG. 2006  
INCOMING MAIL



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BANKA E SHQIPËRISE**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568  
• Fax: ++355 4 223558 • Website [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org) • E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

